

Vendim nr. 189 datë 19.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 19.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 27 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ALMIR DODA**, përfaqësuar nga avokat Ervis Çela, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 894 (86-2023-1227), datë 21.11.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-2172, datë 22.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131, shkronja “f”, 134, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Almir Doda (*kërkuesi*) ka qenë punonjës i Policisë së Shtetit, me gradën inspektor, në detyrën e ndihmës specialistit kontrollor në Seksionin e Kufirit të Komisarariatit të Policisë Kufitare Aeroporti i Rinasit, pranë Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Tiranë. Në vitin 2018 ndaj kërkuesit ka filluar një procedim penal, në kuadër të të cilit, me vendimin nr. 137 akti, datë 28.09.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka caktuar për të masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit”, “Grup i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 298, 333/a dhe 334 të Kodit Penal. Pas zbatimit të masës së sigurimit, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 139 akti, datë 01.10.2018, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të saj, vendim i cili në vijim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr. 37, datë 15.10.2018.

2. Ndërkohë, për rrethana që lidhen me të njëjtën ngjarje, ndaj kërkuesit ka filluar edhe një procedim disiplinor, në kuadër të të cilit Drejtoria e Standardeve Profesionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*DPPSH*) ka përgatitur edhe raportin përfundimtar të hetimit, sipas të cilit kërkuesi dhe një punonjës tjetër i Policisë së Shtetit, në të njëjtën detyrë me të, kanë kryer shkelje të rëndë disiplinore ndërsa kanë mbajtur raporte të afërta me personat për të cilët kanë pasur dijeni, për shkak të detyrës, se kryenin veprimtari të paligjshme, përveçse kanë përdorur pozitën e tyre si punonjës policie për të favorizuar kalimin e paligjshëm të personave të ndryshëm nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke u proceduar edhe penalisht për këtë, procedim në të cilin gjykata ka caktuar për ata masën e sigurimit personal “Arresti me burg”. Mbi këtë bazë, Drejtoria e Standardeve Profesionale pranë DPPSH-së ka rekomanduar ndëshkimin e kërkuesit me masën disiplinore “Përrjashtim nga policia”, mbështetur në nenin 208, pika 3, të Rregullores së Policisë së Shtetit.

3. Në vijim të procedimit disiplinor, drejtori i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin pranë DPPSH-së, me vendimin nr. 184, datë 18.04.2019 (*vendimi nr. 194/2019*) ka vendosur dhënien ndaj kërkuesit të masës disiplinore “Përrjashtim nga policia”. Për ankimin administrativ të kërkuesit, Komisioni Qendror i Apelit pranë DPPSH-së, me vendimin nr. 80, datë 26.06.2019 (*vendimi nr. 80/2019*) ka vendosur të konsiderojë të motivuar masën “Përrjashtim nga policia” të dhënë ndaj tij. Më tej, në zbatim të këtyre vendimeve, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me urdhrin nr. 1145 prot., datë 04.07.2019 (*urdhri nr. 1145/2019*), ka urdhëruar përrjashtimin e kërkuesit nga Policia e Shtetit.

4. Duke mos qenë dakord me masën disiplinore, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me të cilën ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 184/2019 e nr. 80/2019 dhe

të urdhrit nr. 1145/2019, si dhe detyrimin e të paditurit, DPPSH-së, për ta kthyer në detyrën e mëparshme. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3509, datë 28.12.2020, ka vendosur pranimin tërësisht të padisë, duke shfuqizuar aktet administrative objekt gjykimi dhe detyruar të paditurin, DPPSH-në, të rikthejë kërkuesin në pozicionin e mëparshëm të punës, si dhe t'i paguajë pagën nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare 29.09.2018 deri në rikthimin e tij në detyrë. Mbi ankimin e të paditurit, DPPSH-së, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 894 (86-2023-1227), datë 21.11.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin tërësisht të padisë. Për rekursin e kërkuesit Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-2172, datë 22.05.2024, ka vendosur mospranimin e tij.

5. Në datën 24.06.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 02.07.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar:

6.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim të shprehur për pretendimet e ngritura në rekursin e kërkuesit në lidhje me përkufizimin e shkeljeve disiplinore dhe çfarë konsiderohen të tilla sipas ligjit, në një kohë kur gjykatat më të ulëta, pavarësisht se i janë referuar të njëjtit legjislacion, e kanë interpretuar atë dhe kanë arritur në përfundime të ndryshme. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim të shprehur edhe për pretendimet e kërkuesit në lidhje me mënyrën jo të ligjshme të marrjes së provave, pasi gjykata e apelit u është referuar fakteve të vendimit të pushimit të çështjes penale ndaj tij, të cilat nuk përbëjnë provë, përderisa me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk janë konsideruar të tilla që të ngarkonin atë me përgjegjësi penale. Duke vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, pa u dhënë përgjigje pretendimeve të tij me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën e aksesit, përveçse arsytimi i vendimit të saj është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

6.2. *E drejta për punë*, e garantuar nga neni 49, pika 1, i Kushtetutës, si pasojë e interpretimit të pasaktë dhe arbitrar të ligjit për masat disiplinore nga gjykata e apelit dhe mosinterpretimit të tij nga Gjykata e Lartë, pasi duke mos ushtruar ajo funksionin e saj subsidiar për mbajtjen qëndrim të shprehur për pretendimet me natyrë kushtetuese në rekursin e kërkuarit, këtij të fundit i është mohuar e drejta për të zgjedhur profesionin.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji çmos se kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit

gjyqësor i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 22.05.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 24.06.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

11. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, si dhe cenimin e së drejtës për punë në aspektin e zgjedhjes së profesionit.

12. Në kuadër të pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, kërkuesi argumenton, ndër të tjera, se mënyra e marrjes së provave nga gjykata e apelit është jo e ligjshme, pasi ajo u është referuar fakteve të vendimit të pushimit të çështjes penale ndaj tij, të cilat nuk përbëjnë provë, përderisa me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk janë konsideruar të tilla që të ngarkonin atë me përgjegjësi penale.

13. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Referuar në këtë standard kushtetues dhe bazuar në thelbin e këtij pretendimi të kërkuesit, Kolegji vlerëson se ai, pavarësisht se ngrihet në aspektin e mënyrës së marrjes së provës, në të vërtetë ka të bëjë me çështje të vlerësimit dhe shqyrtimit të provave, të cilat, si rregull, janë atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues.

14. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për punë në aspektin e zgjedhjes së profesionit, sipas nenit 49, pika 1, të Kushtetutës, Kolegji mban në konsideratë se argumentet e dhëna nga kërkuesi lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij, për rrjedhojë për të përcaktuar nëse kërkuesit i është cenuar e drejta për punë, është e rëndësishme të analizohet në themel nëse procesi ligjor i zhvilluar nga gjykatat administrative, të cilat kanë dhënë vendimet që kundërshtohen prej tij, kanë përmbushur standardet e procesit të rregullt në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, që *prima facie* përfshihen në kompetencën e kësaj Gjykate, ndaj do të shqyrtohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të aksesit lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

15. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim të shprehur për pretendimet e ngritura në rekursin e tij në lidhje me përkufizimin e shkeljeve disiplinore dhe çfarë konsiderohen të tilla sipas ligjit, në një kohë kur gjykatat më të ulëta, pavarësisht se i janë

referuar të njëjtit legjislacion, e kanë interpretuar atë dhe kanë arritur në përfundime të ndryshme. Duke vendosur mospranimin e rekursit, pa u dhënë përgjigje pretendimeve të tij me natyrë kushtetuese, sipas kërkesit, Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën e aksesit, pasi arsyetimi i vendimit të saj është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

16. Gjykata ka pohuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit përbën një aspekt të saj. Kjo e drejtë përfshin jo vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt *gjykimi (shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjithashtu, ajo ka theksuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, jurisprudenca kushtetuese ka trajtuar edhe qëndrimin që duhet të mbajë Gjykata e Lartë në rastet kur për zgjidhjen në themel të çështjes ka dy vendime diametralisht të kundërta nga gjykatat më të ulëta. Në këto raste, kur nga vendimmarrja e Gjykatës së Lartë cenohen të drejta kushtetuese, ekzistenca e vendimeve diametralisht të kundërta është vlerësuar nën dritën e së drejtës së aksesit të lidhur me atë të ankimit në kuptimin substancial, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e padisë së kërkuetit, duke argumentuar se pala e paditur, DPPSH-ja, dhënien e masës disiplinore “Përrjashtim nga policia” të kërkuetit e ka bazuar vetëm në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për caktimin e masës së sigurimit personal, pra në dyshime dhe jo në prova konkrete, dyshime të cilat nuk janë provuar gjatë procedimit penal, ndërsa me vendimin nr. 1093 akti, datë 04.09.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështja penale në ngarkim të kërkuetit është pushuar, pasi është konkluduar se në veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka shkelje të ligjit dhe akteve nënligjore në ushtrim të detyrës. Me pushimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuetit, pala e paditur, DPPSH-ja, nuk ka arritur të provojë shkeljet e pretenduara disiplinore nga ana e tij. Gjithashtu, ajo gjykatë ka argumentuar edhe se procedura e marrjes së masës disiplinore ndaj kërkuetit nuk është respektuar, ndërsa pala e paditur, DPPSH-ja, nuk duhet të kishte proceduar menjëherë në marrjen e vendimit përfundimtar, por në zbatim të nenit 225, pika 1, të Rregullores së Policisë së Shtetit duhet të kishte vendosur pezullimin e hetimit disiplinor deri sa çështja penale të përfundonte me vendim të formës së prerë dhe në zbatim të pikës 2 po të këtij neni të rifillonte hetimin disiplinor.

19. Në vijim, Kolegji vëren se mbi ankimin e palës së paditur, DPPSH-së, Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke rrëzuar padinë e kërkuetit, me arsyetimin se ndryshe nga sa arsyeton kjo e fundit, nisur edhe nga përmbajtja e vendimit penal të formës së prerë nr.1093 akti, datë 04.09.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konstatohet se kërkueti ka pasur kontakte dhe ka dhënë informacione nëpërmjet telefonit të tij për persona të përfshirë në veprimtari kriminale, informacione të cilat kërkueti i ka marrë duke shfrytëzuar aksesin që ka pasur në sistemin e kalimit kufitar si punonjës i Policisë së Shtetit. Pra, pavarësisht se me vendimin penal në fjalë kërkueti është përjashtuar nga përgjegjësia penale, për shkak se nuk provohej lidhja shkakësore penale ndërmjet veprimeve të kryera nga ai me dashje në shkelje të detyrës me pasojat e parashikuara nga ligji penal për përfitime materiale e të çdo lloji tjetër, kjo nuk do të thotë që ai nuk ka përgjegjësi administrative dhe disiplinore në cilësinë e punonjësit të Policisë së Shtetit. Sipas gjykatës së apelit, vendosja dhe mbajtja e këtyre kontakteve, shkëmbimi i mesazheve me informacione konkrete për persona konkretë, informacione këto të nxjerra nga sistemet e të dhënave të Policisë së Shtetit dhe në përdorim ekskluziv nga policia për qëllime të parandalimit të veprimeve penale etj., në vetvete përbëjnë një shkelje të rëndë të detyrës nga ana e punonjësit të Policisë së Shtetit, sipas nenit 209, pika 1, të Rregullores së Policisë së Shtetit (“Shkelje të rëndë e atributive/kompetencave të policisë”), pavarësisht nga motivi i

kryerjes së këtij veprimi, në kundërshtim me detyrën e tij. Po ashtu, gjykata e apelit ka arsyetuar se edhe procedura e ndjekur për dhënien masës disiplinore ndaj kërkuesit është në respektim të ligjit, ndërsa rezulton që ai të jetë njoftuar për fillim e ecurisë disiplinore dhe për procedurat e komisionit të disiplinës, është dëgjuar nga ky komision në lidhje me shkeljen e atribuar, është njoftuar për vendimin e masës disiplinore dhe ka ushtruar të drejtën e ankimit, ankimi i cili është shqyrtuar nga organi më i lartë disiplinor, Komisioni Qendror i Ankimit, i cili është shprehur me vendim. Për pasojë, sipas gjykatës së apelit, aktet e prodhuara gjatë procesit disiplinor janë produkt i një procesi të rregullt ligjor.

20. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, si dhe referuar materialeve bashkëlidhur kërkesës, Kolegji vlerëson se kërkuesit i është garantuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të cilat kanë dhënë vendimet përkatëse ndaj tij.

21. Gjithashtu, Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit tregon mjaftueshëm rrethanat e çështjes, kërkimet në padi, pretendimet e parashtruara nga palët, përfshirë edhe në ankimet e tyre, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ato, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ajo është bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë, duke argumentuar lidhur me të gjitha pretendimet e palëve dhe vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, por, ndryshe nga ky i fundit, ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit nuk gjenin mbështetje në ligj. Edhe rrjedha logjike e vendimit rezulton e kuptueshme, pjesët e vendimit nuk kanë kontradikta me njëra-tjetrën, argumentet e pjesës hyrëse janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese.

22. Ndërsa vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesi është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore. Ky vendim nuk rezulton të jetë kontradiktor në përmbajtjen e tij dhe kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimet e tij. Interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë nuk rezulton të jetë arbitrar apo haptazi i paarsyeshëm në kuptimin kushtetues, që të cenojë drejtësinë e procesit të rregullt ligjor. Prandaj, Kolegji vlerëson se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, megjithëse me arsyetim të kufizuar, në tërësinë e tij paraqitet i rregullt në formë, i qartë, koherent dhe pa kundërthënie në përmbajtje, duke respektuar standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

23. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit është haptazi i pabazuar, për rrjedhojë edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për punë e profesion është haptazi i pabazuar.

24. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuarit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.